



VENDIM

Nr. 68, Datë 1.07.2013

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PER RINOVIMIN E LICENSËS SË
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “GEN – I
TIRANA” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa g, nenit 8, nenit 10, pika 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit te plote /te pjesshem dhe rinovimit te licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 1.07.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k., për rinovimin e licensës se tregtimit te energjise elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave per rinovimin e licenses shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit të tregtimit te energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Sokol RAMADANI**